

VENDIM
Nr. 104, Datë 20.3.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SEKA HYDROPOWER” SHPK PËR MODIFIKIMIN
E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 146, DATË 10.9.2020, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 10, pika 3, dhe 15, pika 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1011/3 prot., datë 17.3.2023, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 6.2.2023, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Sekë”, me kapacitet të instaluar 12667 kw, për një afat 28-vjeçar.

- Shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1011 prot., datë 6.3.2023, ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës së saj të prodhimit të energjisë elektrike, duke kërkuar që në këtë licencë të shtohet dhe HEC “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, dhe kapacitet total të licencës 14 962 kw.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, për modifikim licence, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim sipas shtojcës 1, shtojcës 2 dhe shtojcës 1/H; informacion ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës dhe çdo parametër teknik që ndryshon; vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës; miratimin/qëndrimin e autoritetit kontraktues (ministria përgjegjëse); miratimin/qëndrimin e organeve përgjegjëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit; miratimin/qëndrimin e organeve përgjegjëse të menaxhimit të burimeve ujore, në rastet e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet; miratimin/qëndrimin e operatorit të rrjetit në lidhje me këtë modifikim, në rastet e ndryshimit të kapacitetit të instaluar (neni 15, pika 4).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin, si vijon: neni 15, “Modifikimi i licencës”, pika 4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.

- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj pagesave të rregullimit ndaj ERE-s dhe po ashtu ka depozituar dokumentacion, në lidhje me kryerjen e pagesës së aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të Rregullores.

- Referuar rrethanave të këtij aplikimi, vlerësohet që për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. të njoftohet Ministra e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar, për modifikimin e kërkuar, si më poshtë:

Në vendimin nr. 146, datë 10.9.2020, të ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 6.2.2023, të shtohet dhe HEC “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kw, dhe kapacitet total të licencës 14 962 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti